



# Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike

---



Autorë: Naim Jakaj dhe Eranda Zekaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan apo të National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

Supported from:



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD  
Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Dhjetor, 2023  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# PËRMBAJTJA

6	SHKURTESAT
7	1. Përmbledhje ekzekutive
9	2. Konteksti
13	3. Ndarja e pushteteve
14	3.1 Kufijtë e përgjegjësisë së Qeverisë dhe të Kuvendit në drejtim të organeve të drejtësisë
14	4. Ndërhyrja përmes deklaratave: Praktikrat dhe standardet Ndërkombëtare
15	5. Ndërhyrjet përmes deklaratave zbehin besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë
17	6. Cenimi i prezumimit të pafajësisë
18	7. Pavarësia financiare dhe funksionale
18	7.1 Mos përmbushja e kërkesave buxhetore
18	7.2 Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve
19	7.3 Cenimi i pavarësisë funksionale
20	8. Si duhet të jetë sjellja e organeve të drejtësisë përballë (tentim) ndërhyrjeve të Qeverisë dhe Kuvendi

## SHKURTESAT

<b>RK</b>	Republika e Kosovës
<b>Kushtetuta</b>	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
<b>PSRK</b>	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
<b>MINT</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
<b>GJK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>GJTHP</b>	Gjykata Themelore në Prishtinë
<b>KRK</b>	Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>QK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>GJS</b>	Gjykata Supreme
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Respektimi i pavarësisë së gjyqësorit, duke përfshirë këtu edhe përmbajtjen e autoriteteve publike nga kritikrat e panevojshme ndaj sistemit të drejtësisë është njëri ndër rekomandimet e fundit që është nxjerë për Kosovën në Raportin mbi Konformitetin e Sistemit Ligjor të Kosovës me standardet e Këshillit të Evropës i publikuar me 27 nëntor 2023 dhe i bërë nga avokatë eminentë nga Byroja e Kuvendit të Këshillit të Evropës.[1] Rekomandimi i tillë ipet edhe në bazë të gjetjeve të prezantuara në këtë raport.

IKD, gjen se Kryeministri, ministrat, zv. ministrat, këshilltarët politikë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, veçanërisht në Legjislaturën e VIII-të kanë qenë të përfshirë në kritika dhe në deklarata të cilat në mënyrë direkte ose indirekte kanë përfshirë ndërhyrjen në sistemin e drejtësisë. Ndërhyrjet janë evidentuar mbi atë që pushteti ekzekutiv dhe legjislativ ka komentuar mbi performancën në sistemin e drejtësisë, në komentimin e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, praktikave dhe standardeve ndërkombëtare pavarësia e gjyqësorit, si pushtet i ndarë nga ai ekzekutiv dhe legjislativ, përbën njërin nga komponentët kyç të shtetit së drejtës. Para së gjithash, neni 4 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [tutje: KEDNJ] garantojnë një gjykatë të pavarur, duke ndaluar kështu që subjektet jogjyqësore të kryejnë funksionin gjyqësor. Rrjedhimisht, kjo ndarje e pushteteve, nuk lejon deklarata nga autoritetet publike të cilat paragjykojnë vlerësimin e fakteve nga autoriteti gjyqësor. Gjykimi publik i bërë nga zyrtarët publik cënon dhe më tej parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili është i mëshiruar në nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mirëpo, pavarësisht nga kjo, gjatë vitit 2022 dhe 2023 ka pasur ndërhyrje të vazhdueshme në pavarësinë e sistemit të drejtësisë, fillimisht nga ekzekutivi përmes vendimeve të qeverisë për uljen e pagave dhe më pastaj këtë ulje duke e përligjë përmes Ligjit për Paga në Sektorin Publik dhe në anën tjetër tjetër, ndërhyrja tjetër që është evidentuar është ajo duke mos bërë ndarjet adekuate buxhetore në ndarjet buxhetore vjetore sipas kërkesave të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Kjo sjellje e kundërt e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ prodhon mosbesim të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Pasi që, pushtetit ekzekutiv dhe ai legjislativ në raport me organet e drejtësisë kanë detyrën e mbështetjes së sistemit të drejtësisë, për aq sa këto pushtete kanë kompetencë dhe të përmbahen nga deklaratat të cilat edhe në mungesë të qëllimit negativ mund të shkaktojnë mosbesimin e qytetarëve në organet e drejtësisë, sidomos në rastet e tyre personale para drejtësisë.

---

[1] Raport mbi Përputhshmërinë e Sistemit Ligjor të Kosovës me Standardet e Këshillit të Evropës, Këshilli i Evropës 2023. ([https://rm.coe.int/application-for-membership-set-out-in-the-letter-of-12-may-2022-address/1680ad7750?](https://rm.coe.int/application-for-membership-set-out-in-the-letter-of-12-may-2022-address/1680ad7750?fbclid=IwAR1born6n9POAgMTëVcZFwejaudc_YqGAlgn6FnDajioBc4uGf9aRhhGm5c) (Qasur për herë të fundit me 28 nëntor 2023).

Raporti “Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike” tregon me shembuj konkret se si disa deklarata të ekzekutivit dhe legjislativit paraqesin ndërhyrje në sistemin e drejtësisë. Më tutje, tregohen praktikat dhe standardet ndërkombëtare mbi bazën e të cilave nuk lejohet kritika e panevojshme, komentimi i vendimeve të gjykatave dhe sulmet ndaj krerëve dhe gjyqtarëve/prokurorëve individualë. Raporti tregon ndarjen e pushteteve, kufijtë e përgjegjësisë së Qeverisë dhe të Kuvendit në drejtim të organeve të drejtësisë, se si ndërhyrjet përmes deklaratave zbehin besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, për pavarësinë financiare dhe funksionale të sistemit të drejtësisë.



## 2. Konteksti

Që nga viti 2018, institucionet e sistemit të drejtësisë kanë qenë të atakuara nga pushteti politik në nivel të Qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ndërhyrjet kanë përfshirë deklarimin e Kryeministrit, zyrtarëve të qeverisë dhe deputetëve mbi performancën në sistemin e drejtësisë, komentimin e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta dhe të Gjykatës Kushtetuese. Ndërhyrjet tjera kanë qenë përmes mos-ndarjeve buxhetore të cilat konsiderohen ndërhyrje e pastërt në pavarësinë financiare të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në anën tjetër ndërhyrjet e tjera kanë qenë ato të cilat kanë përfshirë vendimet për uljen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët.

Në vitin 2018, në takimin e Nivelit të Lartë të Sundimit të Ligjit, Kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Ramush Haradinaj kërkoi nga sistemi i drejtësisë që për një periudhë të caktuar kohore (3 muaj), t'i kryej lëndët e grumbulluara dhe të shënjestruara që lidhen me procesin e liberalizimit të vizave.[2] Deklarimi i tillë, nga shoqëria civile[3] u konsiderua ndërhyrje në sistemin e drejtësisë.[4] Për të njejtën çështje, edhe Komisioni Evropian në raportin vjetor të progresit për vitin 2018 nënvizoi se pati ndërhyrje politike në gjyqësor, veçanërisht tek skemat e pensioneve të veteranëve.[5]

Rasti tjetër i ndërhyrjes së thellë në sistemin e drejtësisë shpërfaqet nga denoncimi publik i prokurorit Elez Blakaj, sipas të cilit ai gjatë punës së tij në hetimin e veteranëve mashtrues ishte përballur me kërcënime të vazhdueshme në lidhje me rezultatin përfundimtar të hetimeve. Për më tepër, me kërkesë të ish-Kryeministrit Haradinaj ai kishte kërkuar nga ish-prokurori Blakaj që ky i fundit të raportojë te Kryeministri lidhur me hetimin e listës së veteranëve.[6] Për këtë rast, edhe ish-deputeti Shkumbin Demaliaj në një intervistë në televizionin publik (RTK) kishte kërcënuar ish-prokurorin Elez Blakaj. Në këtë intervistë, Demaliaj e kishte quajtur Blakajn "kriminel", "dezertor", "hajn", "idiot" e "rrugaç".[7] Demaliaj, ishte arrestuar lidhur me këto akuza nga Policia e Kosovës.

Me 3 janar 2020, Lëvizja VETËVENDOSJE! përmes një komunikate kishte kritikuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me rastin e njohur si "Afera Pronto". Sipas kësaj lëvizje, vendimi i GjThP ishte skandaloz, dëshmi se kjo gjykatat janë të kapura nga ekzekutivi.[8]

---

[2] "Kryeministri Haradinaj: Prokuroria dhe Gjykatat duhet të kenë një plan menaxherial në zgjidhjen e rasteve të grumbulluara dhe atyre të shënjestruara". Zyra e Kryeministrit, 2018. (<https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-haradinaj-prokuroria-dhe-gjykatat-duhet-te-kene-nje-plan-menaxherial-ne-zgjidhjen-e-rasteve-te-grumbulluara-dhe-atyre-te-shenjestruara/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[3] "Ndërhyrjet politike në sistemin e politizuar prokurorial, alarm për nevojën e vetingut në polici, prokurori dhe gjykatat". IKD, 2018. (<https://kli-ks.org/15778/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[4] "Ultimatumi i kryeministrit për gjyqësorin, ndërhyrje në drejtësi". Koha, 2018. (<https://www.koha.net/arberi/107849/ultimatumi-i-kryeministrit-per-gjyqesorin-nderhyrje-ne-drejttesi/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[5] "Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2018, fq 14.". (<https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2019-05/20190529-kosovo-report.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[6] "Dokumenti që dëshmon ndërhyrjen e Haradinajt në gjyqësor." Koha, 2018. (<https://www.koha.net/arberi/112828/dokumenti-qe-deshmon-nderhyrjen-e-haradinajt-ne-gjyqesor/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[7] "Pandëshkueshmëria e korrupsionit rrezik për shoqërinë dhe shtetin, fq. 73." IKD, 2019. (<https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2019/03/1.-Tri-vjet-kunder-korrupsionit-ikd-versioni-SHQIP.pdf?fbclid=IwARITt2l6KlglxAëzZ5Bhc49HhH5aXBwgrK0dH4OXhlEz4iZryD8LMaTgmUA>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[8] "Postim i komunikatës pa titull në rrjetin social Facebook." Lëvizja VETËVENDOSJE!, 2020.

(<https://www.facebook.com/vetevendosje/posts/10156437229542000/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

Edhe pse deklaroi se nuk i komenton vendimet e gjyqësorit, Kryeministri i Kosovës konstatoi në një rast se kur bëhet fjalë për vetveten, gjyqësori del të jetë shumë efikas në raport me lëndët e tjera që i ka në procedurë. Sipas tij, shpejtësia dhe efikasiteti i tyre dëshmon vetëm kur kanë interes për vete dhe atë interesin e ngushtë.[9] Deklarime të tjera ku ndërhyrëse në sistemin e drejtësisë kanë qenë deklarimi i deputetes së LVV-së, Fjolla Ujkani se sistemi i drejtësisë po i saboton denoncimet e pushtetit të Lëvizjes VETëENDOSJE!  
[10]

Me 17 maj 2022, Gjykata Themelore në Prizren shpalli fajtor për keqpërdorim të detyrës zyrtare dy ish-zyrtarë të Komunës së Prizrenit, Islam Thaqi, ish-drejtor i Inspektoratit, i cili në kohën e shpalljes së aktgjykimit ishte asamblist nga Lëvizja Vetëvendosje në Kuvendin Komunal të Prizrenit, dhe Jetmira Vrenezi, ish-udhëheqëse e sektorit të Ndërtimtarisë, aktualisht deputete e LVV-së në Kuvendin e Kosovës, të cilët u dënuan me nga 3 vjet burgim dhe me nga 2.000 euro gjobë për rastin e rrënimit të aneksit të "ABI Çarshisë".[11] Për vendimin e marrë nga GjThP, Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Adnan Rustemi deklaroi se znj. Vrenezi dhe kolegët e saj nuk kanë shkelur ligjin, por "Prokuroria e Prizrenit që i doli në krah paligjshmërisë".[12] Për ccështjen Vrenezi, kishte reaguuar edhe këshilltarja e Ministres, Nazlie Bala duke thënë se vendimi për Jetmira Vrenezin është mbrojtje e uzurpatorëve dhe ndëshkim i atyre që mbrojtën interesin publik. Deklaratën e saj e kishte komentuar Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, duke e cilësuar si të dëmshme.[13] Rasti i Jetmira Vrenezit është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit duke kërkuar nga GjTh në Prizren të veprojë sipas vërejtjeve të cekura të kësaj gjykate, t'i eliminojë kundërthëniet, t'i procedojë edhe një herë të gjitha provat për zbardhjen e drejtë dhe të plotë të gjitha fakteve. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren ishte konsideruar jolëndore.

Kryeministri Kurti, ka komentuar edhe procedurën në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lidhje me rastin ndaj Ndërmarrjes Publike Banesore për një pronë publike, që sipas pretendimeve të asamblistëve të LV-së bëhet fjalë për keqpërdorim të detyrës zyrtare të kësaj ndërmarrjeje. Për këtë rast, Kryeministri Kurti kishte parashtruar një pyetje në rrjetin social të tij në facebook: Kush udhëheq me pavarësinë e gjyqësorit?[14]

---

[9] "Kurti i reagon gjyqësorit: Po del shumë efikas për vetveten." Koha, 2023. ([1] "Kryeministri Haradinaj: Prokuroria dhe Gjykatat duhet të kenë një plan menaxherial në zgjidhjen e rasteve të grumbulluara dhe atyre të shënjestruara!". Zyra e Kryeministrit, 2018. (<https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-haradinaj-prokuroria-dhe-gjykatat-duhet-te-kene-nje-plan-menaxherial-ne-zgjidhjen-e-rasteve-te-grumbulluara-dhe-atyre-te-shenjestruara/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[10] "Deputetja e VV-së: Sistemi i drejtësisë po i saboton denoncimet e pushtetit - Shala i cilëson si ndërhyrje." Ekonomia Online, 2023. ([1] "Kryeministri Haradinaj: Prokuroria dhe Gjykatat duhet të kenë një plan menaxherial në zgjidhjen e rasteve të grumbulluara dhe atyre të shënjestruara!". Zyra e Kryeministrit, 2018. (<https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-haradinaj-prokuroria-dhe-gjykatat-duhet-te-kene-nje-plan-menaxherial-ne-zgjidhjen-e-rasteve-te-grumbulluara-dhe-atyre-te-shenjestruara/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[11] "Gjashtë vjet burgim për dy zyrtarët e Prizrenit për rrënimin e aneksit të "Abi Qarshia" Koha, 2022. (<https://www.koha.net/kosove/325770/gjashte-vjet-burgim-per-dy-zyrtaret-e-prizrenit-per-rrenimin-e-aneksit-te-abi-qarshia/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[12] "Deputeti i VV-së i del në krah koleges që u dënua me tre vjet burgim" Koha, 2022. (<https://staging.koha.net/arberi/325808/deputeti-i-vv-se-i-del-ne-krah-koleges-qe-u-denua-me-tri-vjet-burgim/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[13] "Zogaj: I dëmshëm komentimi që këshilltarja e MD-së ia bëri dënimit të deputetes Vrenezi" Betimi për Drejtësi, 2022. (<https://betimiperdrejttesi.com/zogaj-thote-se-eshte-i-demshem-dhe-i-papranueshem-komentimi-i-keshilltares-se-md-se-per-vendimin-ne-rastin-e-deputetes-vrenezi/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[14] "Kryeministri Kurti: Kush udhëheq me pavarësinë e gjyqësorit?" Koha, 2022. (<https://www.koha.net/arberi/342793/kryeministri-kurti-kush-udheheq-me-pavaresine-e-gjyqesorit/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

Deklarata për mungesën e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në kryerjen e lëndëve kanë bërë edhe zv. ministrat në Qeverinë Kurti 2. Zëvendësministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi kritikoi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), duke thënë se kanë kaluar më shumë se dy vite që kur nuk është ndërmarrë asnjë veprim për lëndën e mirëmbajtjes së urave.[15]

Zv. Ministri i Drejtësisë, me 20 gusht 2023, përmes rrjetit social në facebook kontestoi veprimet e PSRK-së në lidhje me rastin lidhur me rezervat shtetërore, sipas të cilit çështja me karakter komplet civil është duke u tentuar të kthehet në çështje penale si formë hakmarrjeje ndaj qeverisë[16]. Për rastin e rezervave shtetërore, kanë reaguar edhe Ministrja e Drejtësisë dhe Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.[17] Ata hodhën akuza ndaj PSRK-së për neglizhencë në rastet ku ata pretendojnë se ka pasur keqpërdorime por që PSRK deri më tani nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të caktuar.

Kontestimin e veprimeve të PSRK-së, e ka kontestuar edhe Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Punë dhe Transfere, Armend Muja. Ai tha se dosja e prokurorisë ka gabime elementare.[18] Në anën tjetër, edhe vet kreu i Qeverisë, duke kontestuar veprimet e PSRK-së, deklaroi sa nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi, ai ka besim në Ministren Rozeta Hajdari. Sipas tij, hetimet ndaj ministres kanë të bëjnë më shumë me ndërrimin e elitës politike se sa problemeve me ligjin.

Sipas tij, politika e tij është e mirë dhe e ndërgjegjshme dhe fituese, por “humbësit i gjeni tek elita e vjetër dhe e korruptuar politike, te gjykatës dhe prokurorë të saj, te mediat e keqpërdorura për mbështetje të krimit”.[19]

Ministrja e Drejtësisë, ju drejtua qytetarëve në rrjetin social në facebook duke hedhur dyshime mbi PSRK-në me pyetjen se për çfarë dhe për kë punon PSRK? Haxhiu pati thënë se në prokurori dhe në polici kanë dorëzuar shumë denoncime të tjera por që asnjë veprim nuk është ndërmarrë deri më tani.[20] Edhe Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdariu me 21 gusht 2023 përmes një video në rrjetin e saj social në facebook kritikoi sistemin e drejtësisë për mos-reagimin e tyre në rastin e nënshkrimit të një udhëzimi administrativ nga ish-Ministri Vesel Krasniqi. Sipas saj, përkundër dorëzimit të kallëzimit penal në polici dhe prokurori, këto institucione nuk kanë reaguar.[21]

---

[15] “Durmishi kritikon PSRK-në: Mbi dy vjet s’ka asnjë veprim për lëndën e mirëmbajtjes së urave.” Betimi për Drejtësi, 2023. (<https://betimiperdrejtesi.com/durmishi-kritikon-psrk-ne-mbi-dy-vjet-ska-asnje-veprim-per-lenden-e-mirembajtjes-se-urave/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[16] “Postim në rrjetin e tij social në facebook, 2023. ([https://www.facebook.com/blerim.sallahu/posts/10226794755188065?ref=embed\\_post](https://www.facebook.com/blerim.sallahu/posts/10226794755188065?ref=embed_post)). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[17] “Murati e Haxhiu me akuza ndaj Prokurorisë Speciale, 2023 Betimi për Drejtësi.. (<https://betimiperdrejtesi.com/edhe-murati-e-haxhiu-me-akuza-ndaj-prokurorisë-speciale/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[18] “Rezervat dhe Dosja e Prokurorisë, 2023. ([https://www.facebook.com/armendmuja13/posts/631990698914553?ref=embed\\_post](https://www.facebook.com/armendmuja13/posts/631990698914553?ref=embed_post)). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[19] “Kurti thotë se s’ka korrupsion e keqpërdorime me rezervat, përmend prokurorët e elitës së vjetër të korruptuar, 2023 Betimi për Drejtësi. (<https://betimiperdrejtesi.com/kurti-thote-se-ska-korrupsion-e-keqpenderime-me-rezervat-permend-prokuroret-e-elites-se-vjeter-te-korruptuar/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[20] “Postim i Ministres së Drejtësisë në rrjetin e saj sociale në facebook, 2023. (<https://www.facebook.com/albulenaa.haxhiuu/videos/605545918328162/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[21] “Janë bërë më shumë se dy vite, prej kur kemi parandaluar një keqpërdorim multimilionësh dhe kemi dorëzuar kallëzimin penal.” Facebook, 2023. (<https://shorturl.at/FHNX>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

Në një rast tjetër, Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu pati kritikuar sistemin e drejtësisë duke thënë se ky sistem nuk po i kryen detyrat e tyre, sepse sipas saj ky sistem është duke u ballafaquar me një mentalitet patriarkal, ku paragjykojnë dhe neglizhojnë rastet e dhunës në familje.[22]

Me 28 dhjetor 2022, Kryeministri i Kosovës, komentoj propozimin e Prokurorit të PSRK-së Afrim Shefkiu dhe vendimin e Gjyqtarit të GjThP-së, Mentor Bajraktari për ndryshimin e masës së sigurisë për ish-policin serb Dejan Pantiq, i cili nga paraburgimi u dërgua në arrest shtëpiak. Kryeministri Kurti, kishte shprehë kërshërinë e tij për të ditur se “cili është ai prokuror që bën këtë kërkesë, dhe cili është ai gjyqtar që e aprovon”. [23] Po atë ditë, disa qytetarë kryesisht të rinjë vendosen afishe kundër gjyqtarit dhe prokurorit të këtij rasti. Këto afishe shprehnin akuzën për dy zyrtarët e sistemit të drejtësisë si shtyllë të turpit. [24] Së fundi, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër zëdhënësit të LVV-së Arlind Manxhuka dhe këshilltarit të Ministrisë së Shëndetësisë, pjesë e LVV-së, Egzon Azemi si dhe personave me iniciale Q.E. dhe E.Z. për veprën penale “Kanosja “Kanosja” nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, pasi që të njëjtit me dashje kanë kanosur të dëmtuarit Afrim Shefkiun dhe Mentor Bajraktarin. Sipas PSRK-sw, të pandehurit Manxhuka dhe Azemi, “duke keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare nëpërmjet rrjetit social “Facebook”, me dashje kanë përhapur dhe nxitur urrejtje e mos durim ndaj të dëmtuarve, prokurorit A.Sh. dhe gjyqtarit M.B., lidhur me një vendim për ndryshimin e masës së paraburgimit kundër të dyshuarit D.P.” [25]

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese (më tej: GJK) e cila rrëzoi tërësisht Ligjin për Këshillin Prokurorial, Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu mbajti konferencë për media sipas së cilës GJK po e sheh më të rëndësishëm interesin individual të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës së sa interesin e përgjithshëm. [26] Në anën tjetër, kritika jo adekuate pati edhe ndaj Gjykatës Kushtetuese. Ministrja e Drejtësisë vlerësoi së Gjykata Kushtetuese është bërë aleate e opozitës. [27] Ajo këtë deklaram e bëri në lidhje me ligjet e dërguara nga opozita parlamentare në Gjykatën Kushtetuese.

---

[22] “Alarmon Haxhiu: Sistemi i drejtësisë s’po i kryen detyrat, po e bojkoton shtetin.” Gazeta Blic, 2023. (<https://gazetablic.com/alarmon-haxhiu-sistemi-i-drejtësisë-spo-i-kryen-detyrat-po-e-bojkoton-shtetin/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[23] “Kurti pas vendimit për dërgimin e Pantiqit në arrest shtëpiak: Jam kureshtar, kush është prokurori që kërkoi e cili gjyqtar e aprovoi.” Betimi për Drejtësi, 2022. (<https://betimiperdrejtësi.com/kurti-pas-vendimit-per-dergimin-e-pantiqit-ne-arrest-shtepiak-jam-kureshtar-kush-eshte-prokurori-qe-kerkoi-e-cili-gjyqtar-e-aprovoi/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[24] “Grafite ndaj gjyqtarit dhe prokurorit në rastin e ish-policit Pantiq.” Koha, 2022. (<https://www.koha.net/arberi/359040/grafite-ndaj-gjyqtarit-dhe-prokurorit-ne-rastin-e-ish-policit-pantiq/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[25] “Ekskluzive: Çka thuhet në aktakuzën për nxitje të përçarjes dhe kanosjen e gjykatësit dhe prokurorit special” Betimi për Drejtësi, 2023. (<https://betimiperdrejtësi.com/ekskluzivecka-thuhet-ne-aktakuzen-per-nxitje-te-percarjes-dhe-kanosjen-e-gjykatësit-dhe-prokurorit-special/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[26] Ministrja e Drejtësisë: Për Gjykatën Kushtetuese më i rëndësishëm interesin e disa anëtarëve të KPRK-së se sa interesin e përgjithshëm.” Betimi për Drejtësi, 2023. (<https://betimiperdrejtësi.com/ministrja-e-drejtësisë-per-gjykatën-kushtetuese-me-i-rendësisshëm-interesi-i-disa-anëtareve-te-kpk-se-se-sa-interesi-i-pergjithshëm/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[27] “Haxhiu: Kushtetuesja është bërë aleate me opozitën.” Koha, 2023. (<https://www.koha.net/arberi/396518/haxhiu-kushtetuesja-eshte-bere-aleate-me-opoziten/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023)

### 3. Ndarja e pushteteve

**“Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre [...]”[28]**

Ndarja e pushteteve mbetet një parim jetik në funksionimin e shoqërive demokratike, duke shërbyer si një mburojë kundër autoritarizmit dhe abuzimit të pushtetit. Ky parim thelbësor i nivelit më të lartë kushtetues, pos normë kushtetuese, është i mishëruar në frymën e Kushtetutës së vendit dhe si i tillë është i padiskutueshëm. Kushtetuta u ka dedikuar kapitull të veçant tri degëve të të pushtetit: atij ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.[29] Kështu, kjo ndarje bazohen në parime, detyra dhe përgjegjësi, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit dhe balancit pa krijuar “ndërhyrje”, “varësi” dhe “vartësi”, që ndikon në pavarësi të njërit apo tjetrit pushtet.[30]

Në këtë drejtim, tre pushtetet e lartëcekura, ushtrohen nga institucionet përkatëse të secilit pushtet sipas mënyrës institucionale, organizative dhe funksionale, duke ruajtur ekuilibrin kushtetues në çdo instancë ndërvepruese në mes këtyre pushteteve.

Në përputhje me Kushtetutën, **‘Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ’** dhe në kuadër të këtij pushteti ai ushtron një numër të kompetencave, duke përfshirë por jo kufizuar në atë normativ, ligjdhënës, zgjedhore dhe mbikëqyrës. Kështu, si bartës i pushtetit kushtetues dhe ligjor, Kuvendi bën edhe kontrollin apo mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit dhe institucioneve tjera publike që i përgjigjen, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ndërsa, **“Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv” dhe “është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar”**. [31]

Duke pasur parasysh ndarjet e mësipërme, paragrafi 5 i nenit 4 të Kushtetutës parasheh pavarësinë e pushtetit të tretë, atij gjyqësor, i cili “është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat”. Ky përcaktim ndalon që subjektet jogjyqësore të kryejnë funksionin gjyqësor. Kështu, një ndalim i tillë promovon sigurinë juridike dhe lejon interpretim përfundimtar nga gjykatat, jashtë ndikimit të pushteteve tjera. Në këtë formë, përcaktohet në mënyrë shprehimore që ushtrimi i pushtetit gjyqësor ushtrohet nga gjykatat lidhet me parimin e ndarjes së pushteteve, përkatësisht ndalimin e pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv në ndërhyrjen e kompetencave gjyqësore.[32]

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në disa raste kishte shfuqizuar dispozita të caktuara ligjore, me arsyetimin se të njëjtat çënon pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Një ndër këto raste është Ligji nr. 06/L-114 për Zyrarët Publik, për të cilin Ligj kjo Gjykatë nënvizoi se “...[q]everia, respektivisht Ekzekutivi nuk do të ketë kompetenca “ndërhyrëse” në menaxhimin e nëpunësve të Kuvendit, respektivisht Legjislativit; ndërkaq që për pushtetin e Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura nuk është paraparë asnjë garanci...”.

---

[28] Neni 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

[29] Po aty.

[30] Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese mbi vlerësimin e kushtetueshmërisë së Ligjit nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, (<https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-ligjit-nr-06-l-111-per-pagat-ne-sektorin-publik-3/>). (Qasur për herë të fundit me 1 dhjetor 2023)

[31] Neni 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

[32] Po aty.

Mbi këtë dhe arsye të tjera, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi zbatimin e këtij Ligji në raport me sistemin e drejtësisë dhe institucionet e pavarura kushtetuese[33]. Ndërsa, në rastin e Ligjit NR. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, Gjykata Kushtetuese nënvizoi se "...[1] ligji i kontestuar, në zinxhirin përfundimtar vendimmarrës e ka lënë Qeverinë si pushtet që duhet të "aprovojë" çdo propozim të Gjyqësorit. Gjykata konstatoi se, ky rregullim ligjor pa as edhe një dyshim shkon, në mënyrë flagrante, në kundërshtim me nocionin e pavarësisë "institucionale, funksionale dhe organizative" të Gjyqësorit dhe të Institucioneve të Pavarura..."[34].

### 3.1 Kufijtë e përgjegjësisë së Qeverisë dhe të Kuvendit në drejtim të organeve të drejtësisë

Sipas Kushtetutës, Kuvendi dhe Qeveria nuk kanë asnjë kompetencë të vetme për të kërkuar llogari nga sistemi i drejtësisë, ku ky i fundit vet administrohet dhe nuk i jep llogari asnjë pushteti tjetër. Autorizimet që Kushtetuta dhe ligji u ka dhënë qeverisë shtrihen te propozimi i legjislacionit dhe në anën tjetër Kuvendit për miratimit të ndarjeve buxhetore dhe miratimit të legjislacionit përkatës në përputhje me Kushtetutën.

Sa i përket propozim ndarjeve buxhetore nga Qeveria dhe miratimit të këtyre ndarjeve nga Kuvendi i Kosovës, kjo është vetëm përgjegjësi e tyre në kuptimin që mjetet financiare që ndahen janë taksa të qytetarëve për të cilat organet e drejtësisë llogari i japin shoqërisë në përgjithësi dhe në asnjë rrethanë këtyre dy institucioneve. Në lidhje me ndarjet buxhetore, Komisioni i Venecias përmend detyrimin e shtetit në sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për sistemin gjyqësor.[35] Për më tepër, sipas KV-së edhe pavarësisht krizave të mundshme nuk duhet të vije deri te rrezikimi i funksionimit të mirëfilltë dhe pavarësisë së gjyqësorit.

Organet e drejtësisë në asnjë rrethanë nuk mund të jenë objekt i financimit nga vendimet ad-hoc, por në bazë të vendimeve të cilat për bazë kanë objektivitetin dhe transparencën.

## 4. Ndërhyrja përmes deklaratave: Praktikrat dhe standardet Ndërkombëtare

Pavarësia e gjyqësorit është një nga komponentët kyç të shtetit të së drejtës. E drejta për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme garantohet para së gjithash me nenin 6 të KEDNJ, Konventë kjo drejtë për së drejti e zbatuar në sistemin juridik kosovar[36]. Këtë pavarësi të gjykatës, në përputhje me nenin

---

[33] Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese mbi vlerësimin e kushtetueshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët, par. 205 dhe dispozitivi, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29923>, qassur më 21 nëntor 2023.

[34] Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese mbi vlerësimin e kushtetueshmërisë së Ligjit 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, par. 317, 21] "Alarmon Haxhiu: Sistemi i drejtësisë s'po i kryen detyrat, po e bojkoton shtetin." *Gazeta Blic*, 2023. (<https://gazetablic.com/alarmon-haxhiu-sistemi-i-drejtësisë-spo-i-kryen-detyrat-po-e-bojkoton-shtetin/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[35] "Draft Raporti për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa I: Pavarësia e Gjyqëtarëve". CDL(2010)006, 10 dhjetor 2010, Komisioni i Venecias. ([https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL\(2010\)006-e#:~:text=%E2%80%9CThe%20authority%20taking%20the%20decision,decides%20on%20its%20procedural%20rules](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL(2010)006-e#:~:text=%E2%80%9CThe%20authority%20taking%20the%20decision,decides%20on%20its%20procedural%20rules)). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[36] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 (1).



6 të KEDNJ-së, Gjykata e vuri në dukje në veçanti lidhur me parimin e ndarjes së pushteteve ndërmjet ekzekutivit dhe gjyqësorit, duke shprehur rëndësinë gjithnjë më të madhe në praktikën e saj. [37] Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Tutje: GjEDNJ), termi “i pavarur”, përfshin dy elemente, që ndahen në pavarësinë e gjykatave nga ekzekutivi dhe ai i pavarësisë së gjykatave nga palët.[38]

Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve thekson se pavarësia e gjyqësorit shtrihet aq gjërë sa të ndaloj kritikën e ekzekutivit dhe legjislativit mbi vendimet e marra. Përrjashtimisht, dy pushtetet mund të komentojnë vendimet gjyqësore, duke i'u përmbajtur kritikave që mund të ndikojë në pavarësinë apo besimin e publikut në gjyqësor. Gjithashtu, këto dy pushtete duhet përmbajtur veprimeve të cilat vënë në pikëpyetje gatishmërinë e tyre për të respektuar vendimet gjyqësore.[39]

Shmangia nga komentet kritike nga politikanët kërkohet edhe nga Këshilli Konsultativ i gjyqtarëve evropianë, duke shtuar se, pushteti ekzekutiv nuk duhet të inkurajoj mosbindje ndaj vendimeve gjyqësore apo dhunë ndaj gjyqtarëve. Veprime të tilla mund të shkaktojnë ndikim të pahijshëm, presion, nxitje apo dhe ndërhyrje direkte ose indirekte.[40] Thjesht, pavarësia e gjyqësorit nënkupton lirinë nga presioni i jashtëm dhe mungesa e ndikimit apo manipulimit politik, veçanërisht nga ekzekutivi.[41]

Në këtë drejtim, vendimet gjyqësore edhe në aspektin ndërkombëtar lejojnë komentime të kuptimit sqarues, por jo edhe vlerësues. Komentimet e tilla nga ekzekutivi dhe legjislativi, që tregojnë një gjendje reale drejtë përmirësimit të efikasitetit gjyqësor, si ngritje e resurseve njerëzore, trajnime shtesë, apo bashkëpunime brenda kompetencave janë të mirëpritura. Por jo situatat kur komenti ka karakter vlerësues të vendimit gjyqësor. Kjo pasi që mos gatishmëria për të respektuar vendimet gjyqësore dhe kritikën mbi vendosjen në meritat, qartazi cënon pavarësinë dhe ul besimin në publik.

## **5. Ndërhyrjet përmes deklaratave zbehin besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë**

Përgjithësisht ndarja e pushteteve në Kosovë pranohet publikisht nga pushteti politik që është i ulur në karriget e pushtetit legjislativ dhe të pushtetit ekzekutiv. Përkundër kësaj, në politikën ditore të politikave bëjnë pjesë edhe ndërhyrjet ndaj sistemit të drejtësisë përmes deklaratave jo adekuate.

---

[37] *Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 46295/99, para. 78, *GJEDNJ 2002-IV*; shih, gjithashtu *Incal kundër Turqisë*, aktgjykim i 9 qershorit 1998, Raportet e 1998-IV.

[38] *Zand kundër Austrisë*, *Ringeisen kundër Austrisë*, 1971, para. 110.

[39] *Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë*

[40] *Rekomandimi (94)12 ofron (Parimin I.2.d) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë*.

[41] *Lista kontrolluese për sundimin e ligjit nga Komisioni i Venecias*, 2016, [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)007-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)007-e), para.74.

Deklaratat e Kryeministrit, anëtarëve të qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit, për atë se kur duhet të jetë aktive prokuroria, pse në raste të caktuara ajo nuk inicion raste, pse gjykatat japin dënime të ulëta dhe pse ka vonesa në sistemin gjyqësor të rregullt dhe për vonesat në nxjerrjen e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk janë përgjegjësi e tyre kushtetuese dhe ligjore. Për më tepër, kur ato deklarata jipen nga pozita e funksionarit të lartë publik e fituar nga vota e qytetarëve përbën edhe minim të publikut në organet e sistemit të drejtësisë. Një gjë të tillë e konfirmon edhe Opinioni nr.18 (2015) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, ku kritika publike ndaj vendimeve të gjykatave nga ana e politikanëve e minon besimin e publikut në gjyqësorin.[42]

Detyrë e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në raport me organet e drejtësisë duhet të jetë mbështetja për sistemin e drejtësisë, për aq sa këto pushtete kanë kompetencë, dhe jo e kundërta, që përmes deklaratave të cilat edhe në mungesë të qëllimit negativ mund të shkaktojnë mosbesimin e qytetarëve në organet e drejtësisë. Në anën tjetër, përdorimi i argumenteve të thjeshtëzuara nga ana e politikanëve pa analizë përmbajtësore dhe sulmi personal ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve individualë mund të bëjë që qytetarët për raste të caktuara të mos i besojnë në trajtimin e rasteve të tyre. Sipas Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, nuk përjashtohet analiza dhe komentet ndaj vendimeve të gjyqësorit nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, por që kjo analizë dhe kritikë duhet të bëhet në kushte të respektit reciprok, komente të balancuara dhe të përgjegjshme. Sepse në të kundërtën, përveç cenimit të besimit të publikut në gjyqësor, në rastet kur ka kritikë të përditshme dhe masive, pasojat mund të shkojnë deri te ç'ekuilibrimi kushtetues i parimeve demokratike.[43]

Si rast ilustrativ, por jo i vetëm, i cënimit të këtyre parimeve është deklarimi i Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti ndaj Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj pas arrestimit të drejtorit të KEK-ut, Nagip Krasniqi[44], i cili deklarim përbën ndërhyrje të drejtpërdrejt në drejtësi. Kryeministri Kurti, në seancën plenare me 20 prill 2023, tha se Prokurori Blerim Isufaj, po dëshiron të bëhet kryeprokuror, përkundër vullnetit të Presidentes, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit. Ai vazhdoi duke thënë se arrestimi i Kryeshefit të KEK-ut, e ka gëzuar opozitën si dhe përkundër dërgimit të lëndëve nga menaxhmenti i ri i KEK-ut, prokuroria nuk po merret me ato por vetëm me udhëheqjen e re në Kosovë. Kjo sipas Kryeministrit, vie nga një disponim politik negativ nga Prokuroria e Shtetit ndaj qeverisjes së tij dhe posaçërisht ndaj tij.[45] Ky deklarimi i Kryeministrit, në thelb paraqet ndërhyrje në sistem të drejtësisë ngase ai merret me komentimin dhe kontestimin e ndjekjes penale të Kryeshefit Ekzekutiv të KEK-ut, Nagip Krasniqi që në shtetet me demokraci të konsoliduar dhe në shtet të së drejtës kjo praktikë nuk është e lejuar.

---

[42] "Pozicioni i gjyqësorit dhe lidhja e tij me pushtetet e tjera të shtetit në një demokraci moderne." Opinioni nr. 18 (2015), Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (<https://rm.coe.int/16807481a1>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[43] Po aty.

[44] "Kurti për rastin e drejtorit të KEK-ut: Arrestimi i tij e gëzoi opozitën", Betimi për Drejtësi, 2022. (<https://betimiperdrejtesi.com/kurti-per-rastin-e-drejtorit-te-kek-ut-arrestimi-i-tij-e-gezo-i-opoziten/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[45] "Transkript i seancës plenare të Kuvendit, fq. 3 Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 prill 2023. (Shih linkun [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023\\_04\\_20\\_ts\\_Seanca\\_10.00\\_eeqKrijDquJ.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_04_20_ts_Seanca_10.00_eeqKrijDquJ.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023)..



## 6. Cenimi i prezumimit të pafajësisë

Parimi i prezumimit të pafajësisë është i mishëruar në nenin 6 të KEDNJ-së, dhe në vijë me legjislacionin e shteteve të përparuara, ai është i pranishëm edhe në legjislacionin vendor, përkatësisht nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenin 3 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale.

Si një garanci procedurale e procesit penal, prezumimi i pafajësisë vendos kërkesat e veta në rastet ku , ku ndër të tjera, përfshihen edhe shprehjet e parakohshme mbi fajin e të akuzuarit, nga zyrtarët publikë[46], duke përfshirë edhe vetëm një pasqyrim në arsyetim të vendimit rreth asaj se i akuzuari mund të jetë fajtor.[47]

Sipas GjEDNJ, parimi i prezumimit të pafajësisë, nuk lejon deklarata nga autoritetet publike që mund të inkurjojnë publikun të besojë se i akuzuari është fajtor, apo të paragjykojë vlerësimin e fakteve nga autoriteti gjyqësor.[48] Në këtë drejtim, ky parim mund të shfuqizohet vetëm me një vendim përfundimtar në përputhje me ligjin.[49] prej nga duhet theksuar se prezumimi i pafajësisë nuk pushon së zbatuari në procedurën e zhvilluar para apelit, thjesht vetëm se i akuzuari është dënuar në shkallë të parë.[50]

Nga çfarë u theksua, mund të shohim se pretendimet e shprehura me të drejtë lidhur me çështjen brenda procesit të dënimit, pasi i akuzuari është shpallur fajtor, janë të lejuara duke qenë se prezumimi i pafajësisë përjashtohet dhe nuk mund të zbatohet.[51] Megjithatë, ky përjashtim nuk ekziston kur i akuzuari shpallet i pafajshëm. Kjo pasi që prezumimi i pafajësisë nuk lejon trajtim jo korrekt nga autoritetet publike ndaj personave që janë liruar nga akuza penale ose kur procedura penale për ta është pushuar. Mbrojtja e cila është garantuar nga vendimi për lirim ose pushim të procedurës nuk lejon që ata individ të ndihen fajtorë për veprën për të cilën janë akuzuar, duke parandaluar kështu mënyrën se si kjo përceptohet në publik në kuptim të mos cënimit të reputacionit.[52]

Kështu, praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ndalon gjykimin publik të bërë nga zyrtarët dhe autoritetet publike ndaj individëve të liruar sipas një procedure gjyqësore dhe vendimi përfundimtar gjyqësor, pavarësisht vlerësimin meritore të gjykatës mbi rastin konkret.

Udhëzuesi i GJEDNJ-së mbi të drejtën në gjykim të drejtë, i siguron një vend të veçantë situatave lidhur me deklaratat e zyrtarëve publikë, përkatësisht atyre të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ[53] për shkak të prezencës së lartë në publik, që përfshinë këtu dhe situatat si në rastin e Kosovës (Shih Kapitullin II të këtij raporti).

---

[46] *Alenet de Ribemont*, 1995, para. 35-36, Nešták kundër Sllovakisë, 2007, para. 88.

[47] *Cleve kundër Gjermanisë*, 2015, para 41.

[48] *Alenet de Ribemont kundër France*, 10 shkurt 1995, para. 41.

[49] *Shih, Englert kundër Gjermanisë*, nr. 10282/83, raporti i Komisionit i 9 tetorit 1985, Vendimet dhe Raportet (DR) 31, f. 11, para 49, dhe Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë, nr. 10300 /83, Raporti i Komisionit i 9 tetorit 1985, DR 31, f. 12, para. 45).

[50] *Konstas kundër Greqisë*, 2011, Aktgjykim nr 53466/07, para. 36.

[51] *Bikas kundër Gjermanisë*, 2018, para. 57

[52] *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC]*, 2013, para. 94

[53] (*Gutsanovi kundër Bullgarisë*, 2013, para. 194-198); *Konstas kundër Greqisë*, 2011, §§ 43 dhe 45; *Butkevičius kundër Lituaniës*, Udhëzues për nenin 6 të Konventës - E drejta për një gjykim të drejtë (gjykim penal) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut 73/130 Përditësimi i fundit: 31.08.2022 2002, para.

Rrjedhimisht, ky parim në përputhje me praktikën gjyqësore, lejon informimin e publikut mbi hetimet penale në zhvillim, por ndalon deklaratat e zyrtarëve publikë lidhur me hetimet penale në pritje, që paragjykojnë vlerësimin e fakteve nga gjykatat.[54]Vendimet e GJEDNJ-së theksojnë rëndësinë e fjalëve të duhura të zgjedhura nga zyrtarët publikë lidhur me rastet që janë në zhvillim e sipër në gjykata. [55]

Andaj, në çdo deklaratë, zyrtarët publikë duhet të respektojnë vendimet gjyqësore dhe të kenë parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, sidomos në situatat kur personat e caktuar konsiderohet të pafajshëm sipas një vendimi gjyqësor. Në paraqitjet publike, zyrtarët e autoriteteve publike duhet të përmbahen nga fjalët paragjyquese me tendencë ndikimi në besimin e publikut.

## 7. Pavarësia financiare dhe funksionale

### 7.1 Mos përmbushja e kërkesave buxhetore

Mos përmbushja e kërkesave financiare të institucioneve të sistemit të drejtësisë (KGJK dhe KPK) si dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Akademisë së Drejtësisë kishte ndodhur me ndarjet buxhetore për vitin 2023. Fillimisht Qeveria e më pas edhe Kuvendi nuk i kishte miratuar kërkesat e këtyre institucioneve[56]. Sipas këtyre institucioneve, përmbushja e këtyre kërkesave do të mundësonte përmbushjen e mandatit të plotë të tyre. Siç e thonë edhe raportet e KV-së, shtetet kanë për detyrë që të ofrojnë mbështetje financiare për sistemin e drejtësisë në përputhje me nevojat e sistemit të drejtësisë.[57] Për më tepër, sipas këtyre parimeve mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit bëhet vetëm duke pasur autonomi administrative dhe financiare. Komisioni i Venecias në opinionet e tij përmend se ruajtja e pavarësisë e sistemit gjyqësor bëhet vetëm përmes ndarjes së nevojshme të buxhetit në mënyrë që të ruhet dhe të nxitet besimi i publikut te drejtësia dhe sundimi i ligjit.[58]

### 7.2 Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Me 20 dhjetor 2017, Qeveria e Kosovës e udhëhequr atë kohë nga Kryeministri Ramush Haradinaj kishte nxjerrë Vendimin nr. 04/20[59] sipas të cilit një kategori të caktuar të pozitave të kabinetit qeveritar u rritej paga dhe atë duke përfshirë Kryeministrin, zëvendës kryeministrat, ministrat, këshilltarët dhe një kategori të shërbyesve civilë. Vendimi i tillë në mënyrë automatike i rriste pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve ngase sipas Nenit 35 të Ligjit për Gjykatat[60] dhe Nenit 21 të Ligjit për Prokurorit të Shtetit[61].

---

[54] Ismoilov dhe të tjerët kundër Rusisë, 2008, para. 161; Butkevičius kundër Lituanisë, 2002, para. 53).

[55] Dakaras kundër Lituanisë, 2000, para. 41; Arrigo dhe Vella kundër Maltës, 2005; Khuzhin dhe të tjerët kundër Rusisë, 2008, para. 94.

[56] *Drejtësia në Buxhetin për vitin 2023, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2023*, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2023.

(<https://kli-ks.org/drejtësia-ne-buxhetin-per-vitin-2023-pas-hyrjes-ne-fuqi-te-ligjit-per-ndarjet-buxhetore-per-vitin-2023/>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[57] *Opinioni nr. 2 (2001), par. 4, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, 2001.* (<https://rm.coe.int/1680747492>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[58] *"Raport mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve"* par. 2. CDL-AD(2010)004, 16 mars 2010, Komisioni i Veneciasë.

[59] *Vendimi nr. 04/20, 20.12.2017*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62460>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[60] Ligji për Gjykatat, I qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>.

[61] *Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit (i shfuqizuar)*. I qasshëm nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>.

Përkundër kontestimit të legjitimitetit dhe ligjshmërisë nga ana e shoqërisë civile, një vendim i tillë kishte nisur të zbatohet për kabinetin qeveritar, rrjedhimisht edhe për sistemin e drejtësisë.

Me 12 shkurt 2020, Qeveria e Kosovës nën kryesimin e Kryeministrit të Kosovës Albin Kurti kishte marrë vendim për shfuqizimin e një dispozite ku ishin rritur pagat e kabinetit qeveritar.[62] Vendimi nuk zvogëlonte pagat e rritura në sistemin e drejtësisë sipas të një pjese të vendimit të shfuqizuar, përderisa për këtë çështje një vendim tjetër do të mirrej pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin Nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. GjK, me 30 qershor 2020 në Aktgjykimin Nr. KO219/19 shfuqzoi Ligjin për Pagat, ku për pagat në sistemin e drejtësisë përmendte në mënyrë taksative se pagat për sistemin e drejtësisë nuk mund të uleshin në formë arbitrare, pa arsyetim të mirëfilltë dhe të paqëndrueshëm, e në rast të marrjes së një vendimi ai duhet t'i respektojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të jetë në pajtim me parimin e parashikueshmërisë, sigurisë juridike dhe atë të sundimit të ligjit. [63]

Përkundër faktit se ishte në dijeni të këtij aktgjykimi, Qeveria e Kosovës me 23 nëntor 2022[64],përmes vendimit arbitrar, pa konsultime publike dhe në mënyrë të kundërligjshme vendosi të ulë pagat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Vendimi i tillë ishte në kundërshtim me vet përgjigjet e KV-së në lidhje me pyetjet e GjK-së për uljen e pagës për pushtetin gjyqësor. Sipas KV-së, “Ulja e pagave të gjyqësorit mund të ndodhë vetëm nën kushte të një krize të theksuar ekonomike dhe financiare dhe e cila për më tepër duhet të jetë e njohur zyrtarisht si të tillë” dhe se “Pavarësia gjyqësore kërkon një shkallë themelore të sigurisë financiare nga ndërhyrjet arbitrare nga ekzekutivi ose degët e tjera të pushtetit”. [65]

### 7.3 Cenimi i pavarësisë funksionale

Me miratimin e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria dhe Kuvendi cenoi pavarësinë funksionale në sistemin e drejtësisë fillimisht tek ulja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pastaj pamundësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese që të ndryshojnë strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave dhe në rastin tjetër që edhe në rast të krijimit të funksioneve, pozitive apo emërtesave të reja, “institucioni në të cilin krijohet pozita kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike përcaktimin e klasës së pagës që zbatohet për atë funksion, pozitë apo emërtesë në bazë të ekuivalencës”. Edhe pse me paragrafin 4 të të njejit nen u lihet mundësia

---

[62] *Vendimi nr. 01/02, 12.02.2020*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2020. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71845>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[63] *Aktgjykim në rastin KO 219/19*, par. 303, Gjykata Kushtetuese. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2020. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29924>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[64] *Vendimi nr. 03/109, 23.11.2022*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2020. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66799>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

[65] *Aktgjykim në rastin KO 219/19*, par. 328, Gjykata Kushtetuese. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2020. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29924>). (Qasur për herë të fundit me 2 nëntor 2023).

institucioneve të pavarura që me akte të brendshme të krijojnë funksione/pozita/emërta të reja, tre paragrafët e parë të nenit përcaktojnë rregullta të përgjithshme me ç'rast i kufizojnë institucionet e pavarura të kenë autonomi të plotë funksionale. Tre dispozitat e nenit 42 të Ligjit për Paga, sistemin e drejtësisë e vendosin në detyrime ndaj ministrisë përgjegjëse për administratën publike për çështje të cilat Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin Nr. KO219/19 në ligjin paraparak të pagave i kishte cilësuar si kundërkushtetuese. Sipas GJK-së, duke qenë së bëhet fjalë për përmbajtjen e njejtë të nenit të ligjit për pagat në sektorin publik të kaluar me këtë aktualin, GJK përmend probleme serioze konceptuale dhe praktike të këtij neni në disfavor të Gjyqësorit dhe Institucioneve të Pavarura. Kundërkushtetuese dhe në kundërshtim me praktikën dhe standardet nddërkombëtare do të ishte që përmes kësaj dispozite organet e sistemit të drejtësisë t'i drejtohen Qeverisë për të kërkuar leje dhe miratim për krijim të një pozite të re dhe për të kërkuar leje dhe miratim për ndryshim të strukturës së brendshme organizative.[66]

## **8. Si duhet të jetë sjellja e organeve të drejtësisë përballë (tentim) ndërhyrjeve të Qeverisë dhe Kuvendit**

Sipas opinioneve të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë, gjyqësori duhet të jetë i gatshëm të pranojë kritika sepse kjo përbën edhe dialog ndërmjet tre pushteteve dhe dialog me shoqërinë në përgjithësi. Në këtë dialog, sipas KKGjE-së kritika ndaj organeve të sistemit të drejtësisë duhet të jetë legjitime, duhet të ketë respekt dhe të mos ketë presion ndaj gjyqësorit. Dialogu i mirëfilltë ndërmjet tre pushteteve në masën që nuk cenohet pavarësia e tyre funksionale përbën shëmbull praktik të shtetit të së drejtës, veprim i cili ndikon në forcimin e demokracisë moderne.

Kuptimi i kësaj kritike qëndron në komentet që kanë qëllimin përmirësimin e sistemit gjyqësor, drejtë zgjidhjes së praktikave më të mira të drejtësisë. Andaj, ky dialog, si bashkëpunim ndër pushtete duhet të ketë në qendër të mirën e përgjithshme publike dhe interesin më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, edhe në rastin e paraqitjes së situatave të cilat paragjykojnë dhe ndikojnë në procesin gjyqësor, duke përfshirë edhe situatat ku deklaratat u drejtohen akterëve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të tyre pas marrjes së vendimit meritator, organet e drejtësisë duhet të përmbahen karshi ngjarjeve të tilla dhe të mos lejojnë ndikime të jashtme. Evitimi i situatave sipas së cilave mund të krijohet ndërhyrje, mund të arrihet çdoherë kur organet e drejtësisë veprojnë në kuadër të kompetencave të tyre, sipas kushtetutës dhe ligjit.

Në rastet kur vendime të caktuara atakojnë pavarësinë e sistemit të drejtësisë, reagimi i institucioneve të sistemit të drejtësisë duhet të jetë adekuat.

Situatë e keq reagimit ishte rruga e ndjekur nga KGJK ndaj vendimit të Qeverisë për ulje të pagave. KGJK bojktoj punën në gjyqësor, duke reduktuar kështu punën në gjykata. Megjithatë, përballë një vendimi të tillë të Qeverisë, shëmbull adekuat do të ishte ndjekja e rrugëve ligjore dhe jo marrja e veprimeve që shkojnë në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

---

[66] Po aty, par. 317.

Në këtë drejtim, rruga adekuate përmes paraqitjes së padisë në Gjykatë u ndjek nga Shoqata e Prokurorëve, më 29 nëntor, ku krahas padisë kërkohet edhe caktimi i masës së përkoshme për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit për uljen e pagave.





*Raporti "Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike" është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan apo te National Endowment for Democracy (NED).*



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD